



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 206, datë 29.12.2020**

**PËR  
MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË SHOQËRISË “CREDINS INVEST” SH.A  
SHOQËRI ADMINISTRUESE E SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE  
ME OFERTË PUBLIKE, ME KËRKESAT E LIGJIT NR. 56/2020 “PËR  
SIPËRMARRJET E INVESTIMEVE KOLEKTIVE”**

Në bazë të nenit 14, pika 4 dhe 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, pikës 3, të nenit 238, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe pikës 6, të nenit 57, të Rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë “Credins Invest” sh.a. shoqëri administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, me kërkesat e Ligjit 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe rregulloreve të dala në zbatim të tij.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**ANËTAR  
Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Ervin METE**